



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:141868
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06362505

2024:036274

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, me bashkëpunëtoren profesionale Fitore Hasani – Ismaili, në çështjen kontestimore të paditësit S.T, nga fshati S..., Komuna Ferizaj, me numër personal të cilin e përfaqëson avokati Xhevat Balaj nga Prishtina, Ulpiana A5, Hy. 4, Nr. 5, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S....” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ylli Musa nga Prishtina, me bazë juridike kompensim dëmi material dhe jo material, me vlerë të kontestit 8,080.45€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse mori, ndërsa me datën 28.10.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.T nga nga fshati Sojevë, Komuna Ferizaj kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S....” me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “S....” me seli në Prishtinë, që sipas përgjegjësisë të ndarë, 80% të siguruarit të paditurës dhe 20% të paditësit, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 11.06.2019, rreth orës 08:02 min, lokacioni fsh. Sojevë-Ferizaj, sipas raportit të aksidentit, t’ia paguaj paditësit shumën edhe atë:

Në emër të dëmit jo material (satisfaksion):

-Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....1,100 €
-Për frikën e përjetuar, shumën prej.....900,00€

Në emër të dëmit material:

-Për ndihmën e personit të tretë dhe kujdesin e huaj, për 18 ditë, për shumën prej180,00 €

-Për ushqim të përforcuar, për 18 ditë, shumën prej..... 180,00 €

- Në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej..... 75.95€,

Gjithsej shuma për kompensim: **2,435.95€**

(dymijë e katërqind e tridhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e pesë cent).

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, që paditësit S.T, shumat e gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguajë së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt. 28.10.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.02.07.2019, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.T kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 3,200€, në emër të frikës shumën prej 2,300 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 90,00€, në emër të shpenzimeve të shërimit 54.5€, në emër të shpenzimeve të rehabilitimit fiziatriko për 10 ditë.

IV. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesa e paditësit S.T sa i përket kompensimit të shpenzimeve procedurale ashtu që **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë që t’ia paguaj paditësit S.T, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1242,8 Euro (njëmijë e dyqind e katërdhjetë e dy euro e tetëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, ndërsa **refuzohet pjesërisht si e pabazuar** diferenca e kërkuar në emër të shpenzimeve procedurale në lartësinë prej 506.2€ (pesëqind e gjashtë euro e njëzetë cent).

A r s y e t i m i

Rrjedha e çështjes

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.733/19, të dt. 18.02.2021, ka vendosur I. Aprovohet, pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.T, nga fshati Sojevë komuna e Ferizajt, ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S....”, me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 11 qershor 2019 t’ia paguaj edhe atë për dëmin material dhe jo material: Për dhimbje trupore –fizike shumë prej 700.00€, Për frikën e shkaktuar shumë prej 400,00€, Për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë shumë prej 270,00 €, Për fitimin ushqimin e përforcuar shumë prej 180,00 €, Shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumë prej 130.45, 00€. Gjithsej shumë në lartësi prej 1.680.45 € (njëmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë euro e dyzetë e pesë cent) të cilën e paditura DETYROHET që t’i kompensoj paditëses në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të aktgjykimit dhe atë me kamatë ligjore pre 8 % duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit (4 shkurt 2021) e deri në pagesën definitive. II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I. të këtij dispozitivi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 574.00€ (pesëqind e shtatëdhjetë e katër euro) në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përbarimit me dhunë. III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiës mbi shumat e miratuara në lartësi prej 6.400 € (gjashtëmijë e katërqind euro) si dhe pjesa tjetër kërkesës së shpenzimeve të procedurës përtej shumës së aprovuar, në lartësi prej 635.00 € (gjashtëqind e tridhjetë e pesë euro) si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë me aktvendimin Ac.nr.3315/2021, të datës 16.01.2024, ka vendosur aprovohet e themeltë ankesa e paditësit S.T dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S....” me seli në Prishtinë, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.733/19, të dt. 18.02.2021 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi përmes të autorizuarit të tij më datën 02.07.2019 ka paraqitur padinë në gjykatë lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material. I autorizuari i paditësit av. Xhevat Balaj në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës, parashtesës për precizimin e kërkesëpadiës, kërkoj nga gjykata qe kur te vendos per kamatën, kamatën ta vendos per demin jo material nga data 18.02.2021 kur eshte nxjerrur Aktgjykimi C. Nr. ..., nga fakti se sipas mendimit juridik te Gjykares Supreme kamatat per demet jo materiale do te vendosen nga nxjerrja e Aktgjykimit te shkalles se pare, ndërsa te

njëjtë mendim kamata për demin jo material do të llogaritet nga dita e shkakimit të demit, përkatësisht nga ... ,pra gjykata kur të vendos për kompensim të llogaritet nga data, data kur është shkaktuar demit. Kërkojmë nga gjykata që në emër të shpenzimeve procedurale të kërkojmë 1209 euro për shpenzime të procedurës sipas aktgjykimit C,nr., të specifikuar sipas parashtrësës për precizimin e padisë e dt., si dhe kërkoj edhe 270 euro për dy seanca të mbajtura në rigjykim. Precizimet e kërkesë padisë të kam bazuar në mendimin juridik për kompensimet e dëmeve jo materiale të Gjykatës Supreme të Kosovës.

E paditura përmes të autorizuarit të saj Ylli Musa nga Prishtina, në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet në tersi si në përgjegjësinë në padi dhe të gjitha deklaratime në seancat e kaluara, sa i përket bazës juridike theksojmë se në provat e nxjerruar në ekspertizë dhe plotësimin e ekspertizës është konstatuar se kontribut në shkaktimin e këtij aksidenti ka dhënë edhe vete paditësi si ngasës i automjetit nën B . andaj gjykata në vendosje ta marrë për bazë kontributet e të dy pjesëmarrësve në aksident. Sa i përket precizimit të kërkesë padisë e kontestojmë në tersi si tepër të lartë të pa justifikuar dhe në kundërshtim me rregullatën e BQK-se, rregulloren për vlerësimin e kritereve të dëmeve jo materiale dhe materiale , si dhe në kundërshtim me ekspertizat e nxjerrura mjekësore ngase mjekët kanë konstatuar se kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore pa kurrfarë pasojash. Shumat e kërkuara në precizim e tejkalojnë satisfaksionin real për kompensimin e demit, ndërsa thirrja në mendimin e dhënë nga gjykata Supreme nuk qëndron për faktin se ky mendim është vetëm një udhëzim por jo edhe detyrim për gjykatën , ndërsa mendimi i gjykatës hyn në fuqi dhe zbatohet me dt. 27.02.2023, ndërsa aksidenti ka ndodhur me datë 11.06.2019. precizimi i kërkesë padisë është në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore nën 183 të LMD-se, lidhur me dëmshpërblimin si dhe në kundërshtim me praktiken gjyqësore. E paditura duke u bazuar në vlerësimin mjekësor dhe kriteret për vlerësimet e dëmeve material dhe jo material për paditesin ofron shumë prej 700 euro duke marrë për bazë edhe ndarje e përgjegjësisë dhe kërkoj nga gjykata që mbi këto shumë padin dhe kërkesë padin ta refuzoj si të pa bazuar. Sa i përket kamatës me qene se është prishur aktgjykimi në tersi kërkojmë nga gjykata që kamata të zbatohet për demin jo materiale nga data e aktgjykimit të ri, po ashtu kërkojmë nga gjykata që lidhur me kamatën të zbatohet mendimi juridik i gjykatës supreme lidhur me kamaten. E kundërshtojmë kërkesë e precizuar sa i përket shpenzimeve të procedurës dhe kërkojmë nga gjykata që të zbatohet ndarja e përgjegjësisë dhe parimi i suksesit në procedurë nën 452.2 të LPK-se.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë të gjendjes faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar një sërë provash, edhe atë: Raporti policor i aksidentit i datës 11 qershor 2019, Raporti i Spitalit të Përgjithshëm-Qendra Emergjente në Ferizaj numër 624 i datës 11 qershor 2019, Dokumentacioni mjekësor i lëshuar nga institucione të ndryshme mjekësore, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të ortopedisë Dr. Milazim Haxholli i datës 9 mars 2020, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të psikiatrisë Dr. Muharrem Asllani i datës 24 korrik 2020 dhe ekspertiza e komunikacionit e datës 18.09.2020, si dhe plotësimi i ekspertizës i dt. 23.07.2024, e ekspertit Xhemil Halili, nga Ferizaj, shqyrtimi i kërkesës nr. 5589 i dt. 10.07.2024 i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve.

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 199 të LPK në kuptim të vërejtjeve dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës të dhëna në aktvendimin Ac.nr....., të datës 16.01.2024 të cilat janë të obligueshme për këtë gjykatë, konform nenit 362.1 të LPK, e ka ftuar ekspertin e komunikacionit Xhemil Halili në shqyrtim gjyqësor të dt. 04.07.2024 dhe 25.09.2024 për të dhënë sqarime shtesë, ku palët e kanë pasur mundësinë të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime shtesë nga ana e ekspertit. Gjykata me aktvendimin e marrë në shqyrtimin e dt. 03.07.2024 ka vendosur i kthehet në plotësim ekspertiza e datës 18.09.2020 ekspertit nga lëmi i komunikacionit Xhemil Halili nga Ferizaj, ashtu që pas kërkesës në formë të shkruar Ministrisë së Infrastrukturës si përgjegjëse e kësaj rruge të plotësojë me të dhëna të sakta dhe konkrete të plotësoj ekspertizën se me datën e aksidentit 11.06.2019 cilat nga shenjat e komunikacionit kanë qenë të vendosura në atë kohë në atë rrugë, në mënyrë që të hiqen dilemat se a ka pasur kontribut vetura "B"- Renault Megan me vozitës paditësin S.T, nga fshati Sojevë, Komuna Ferizaj, si dhe se sa ka qenë shpejtësia maksimale e lëvizjes e lejuar në vendin ku ka ndodhur aksidenti.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nuk rezulton të jetë kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse fakti se automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar tek e paditura.

Kontestuese në këtë çështje mbetet pjesërisht baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit, ku e paditura pretendon se paditësi në aksidentin e 11.06.2019 ka përgjegjësi sekondare, si dhe kontestuese mbetet çështja e lartësisë së kërkesëpadisë së paditësit.

Me leximin e ekspertizës gjegjësisht plotësimit të ekspertizës së komunikacionit të dt....., gjykata ka vërtetuar se aksidenti ka ndodhur me lëshimet e ngasësit të njësisë një (VW Golf) dhe kontributin e ngasësit të njësisë dy (Renault Megane). Ngasësi i njësisë një (VW Golf) me veprimin e kthimit majtas pa i dhënë përparësi kalimi automjetit përballë dhe pa u siguruar për distancën e sigurt përkatësisht ka filluar kthimin kur automjeti përballë (Renault Megane) ka qenë në distancë më të shkurtë se ajo e sigurt, andaj ky lëshim i ngasësit të njësisë (VW Golf) është lëshim që lidhet me shkaktimin e aksidentit. Sa i përket njësisë dy (Renault Megane), u pa se po të kishte drejtuar automjetin me shpejtësi prej 50 km / h do të kishte mundur ta shmang aksidentin. Në këtë rast lëshimet do të ishin lidhur me mundësinë e shmangies së aksidentit, pasi që ngasësi i kësaj njësie do të kishte mundësi teknike ta shmang aksidentin në fjalë, për shkak se rruga e ndaljes do të ishte më e shkurtë se ajo që kishte në dispozicion ngasësisë i njësisë dy (Renault Megane). Ka shtuar se lëshimet e automjetit Renault Megane kanë të bëjnë me mundësinë e shmangies së aksidentit. Për shkak se sikur se automjeti Renault të lëvizte me shpejtësinë 50 km për orë, me frenim do të mund të shmangej aksidenti. Ndërsa i njëjti ka lëvizur me shpejtësinë prej 62.46 km për orë.

Me leximin e shqyrtimit të kërkesës nr. ...i dt. ... i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve, gjykata ka vërtetuar se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit-Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve, nuk kanë të dhëna konkrete, për vendin e caktuar sipas kërkesës së ekspertit të komunikacionit, se sa ka qenë kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes në kohë të caktuar përveç asaj se është në gjendje aktuale.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë dhe kjo përgjegjësi sipas vlerësimit të kësaj gjykate për të paditurën si përgjegjëse primare është vlerësuar me 80%, ndërsa 20% këtu paditësit. Mbi këtë bazë është vendosur sipas Nenit 176 (Përgjegjësia e ndarë), paragrafi 1 të LMD ku parashihet se: “1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.”

Sipas propozimit të palës paditëse, është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës mjekësore, dhe atë me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë, respektivisht e psikiatrisë, me ç'rast për ekspertë janë caktuar Dr. Milazim Haxholli - ortoped - traumatolog dhe Dr. Muharrem Asllami - psikiatër. Ekspertët e lartëcekur kanë pasur për detyrë që në bazë të njohurive profesionale, pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit dhe vlerësimit të dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës të japin mendimin e tyre profesional lidhur

me shkallën dhe intensitetin e lëndimeve të pësuar, dhimbjeve fizike, frikës, si dhe të konstatojnë nëse te paditësi si pasojë e aksidentit ka ardhur në shprehje zvogëlimi i aktivitetit jetësor, shëmtimi, nëse ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë, e po ashtu vlerësimi i faktit nëse shpenzimet e shërimit i përshtaten natyrës së lëndimeve të pësuar.

Ekspert Dr. Milazim Haxholli, Ortoped - Traumatolog ka dhënë mendimin dhe konstatimin e tij me shkrim me dt. 09.03.2020, ku ka konstatuar se pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, i njëjti si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje e unazave të qafës, ndrydhje në krahun e majtë, lëndimet janë të shkaktuara nga rënia, goditja në sipërfaqe të fortë si pasojë e aksidentit në trafik dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore. Në raport me dhimbjet fizike, ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë nuk ka pasur, dhimbjet e intensitetit të lartë-rëndë kanë zgjatur 1 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur 18 ditë, kohe pas kohe gjer në marrjen e terapisë adekuate, të cilat ndërliidhen me kohën e nevojshme për konsolidimin e lëndimeve të qafës, krahut, dhimbje fizike të intensitetit të ulët, ka edhe sot e kësaj dite posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike, nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si dhe nuk ka shëmtim trupor. Ndihma dhe kujdesi i huaj ka qenë e nevojshme për 18 ditë. Ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë-ushqim të pasur me proteina, vitamina, minerale. Rehabilitimi fiziatriko-psikik ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditësh.

Ekspert Dr. Muharrem Asllani - psikiatër ka dhënë mendimin dhe konstatimin e tij me shkrim me dt. 24.07.2020, ku ka konstatuar se klienti në bazë të dokumentacionit ekzistues prej incidentit në të cilën e ka përjetuar është manifestuar me prezencën e frikës sekondare e intensitetit të lartë që ka zgjat një javë si gjendje akute në stres që është manifestuar me pengesa në gjumë nga ankthet e natës me përmbajtje të aksidentit, me reagime emocionale, shqetësim, pa rehati dhe rikujtime të shpeshta të aksidentit. Pas kësaj frika kalon në frikë sekondare të intensitetit të mesëm që zgjat dy javë, frika sekondare e intensitetit të ultë ka zgjatë tri javë me të njëjtat simptome të lartcekura por me intensitet me të ulët me mundësi ringjallje sa herë që flitet për ngjarje të ngjashme traumatike.

Baza juridike

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur, referuar momentit kur është krijuar raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse, duhet referuar dispozitave të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve.

Dispozita nga neni 137 e këtij ligji përcakton definicionin e dëmit dhe është e formuluar në këtë mënyrë: "Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)". Në këtë mënyrë, nga interpretimi i dispozitës së lartcekur rezulton se ekzistojnë dy kategori të dëmit: 1) dëmi material, i cili ndahet në dy nënkategori: 1) zvogëlim i pasurisë dhe 2) pengim i rritjes së saj dhe 2) dëmi jo material, i cili konsiston në shkaktim të dhimbjeve fizike, vuajtjeve psikike dhe frikës.

Detyrimin për shpërblimin e dëmit material e definojnë dispozita e nenit 169 të këtij ligji, e cila parasheh që: "Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme". Në funksion të njëjtë, dispozita e nenit 174 përcakton që: "Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim".

Në anën tjetër, çështja e shpërblimit të dëmit jo material përcaktohet me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, e cila parasheh që: "Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga

shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror."

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata nga analizimi i të gjitha raporteve mjekësore të paditësit veç e veç të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të cilat janë në emër të paditësit, ka vërtetuar faktin se paditësi si rezultat i aksidentit ishte dërguar për të marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor. Këto raporte mjekësore kanë pasqyruar gjendjen reale dhe faktike të shëndetit të paditësit pas ndodhjes së aksidentit dhe se nga këto raporte janë bazuar edhe ekspertët përkatës të cilët kanë bërë ekspertizën mjekësore, ku vërtetohet lidhja shkakore në mes të shaktimit të dëmit dhe lëndimeve të lehta trupore të paditësit. Në rastin konkret, në bazë të të gjitha provave të administruara, e në kuptim të dispozitave të lartcekura, rezulton se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të dt 11.06.2019, ka pësuar dëm jo material (i cili konsiston në dhimbje fizike dhe frikë), si dhe dëm material, (i cili konsiston në nevojën për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar, dhe shpenzime të shërimit). Kategoritë e lartcekura të dëmit të pësuar, përfshirë edhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre janë të specifikuar në ekspertizën mjekësore, të punuar nga ekspertët Dr. Milazim Haxholli - Ortoped - Traumatolog dhe Dr. Muharrem Asllani - psikiatër. Të gjeturat e këtyre ekspertizave janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsytimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor. Mbi këtë bazë, Gjykata ekspertizave në fjalë ja fali besimin e plotë, për faktin se janë përpiluar në mënyrë profesionale dhe mbi bazën e vlerësimit të parametrave të nevojshëm në drejtim të sqarimit të rrethanave vendimtare sa i përket vendosjes së kësaj çështje. Krahas vërtetimit të faktit se paditësi ka pësuar format e lartcekura të dëmit, buron edhe detyrimi i të paditurës për shpërblimin e të njëjtit. Bazuar në natyrën e dëmit të pësuar, rivendosja e gjendjes së mëparshme për paditësin është e pamundur, andaj shpërblimi i dëmit mund të realizohet përmes caktimit të detyrimit të të paditurit për pagesën e një shume të të hollave.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi që në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbjet fizike të përjetuara ta detyrojë të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,100€ Euro, duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve të konstatuara nga ekspertiza mjekësore.

Në emër të dëmit jo material për frikën e përjetuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 900,00 Euro, po ashtu duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga aksidenti, të specifikuar në ekspertizën mjekësore.

Lidhur me shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, Gjykata iu referua edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, 41/2023, të dt. 27.02.2023, me të cilin janë përcaktuar disa kriteret orientuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, e po ashtu duke pasur parasysh se paditësi sipas ekspertizës gjegjësisht plotësimin të ekspertizës së komunikacionit kishte lëshime të natyrës sekondare duke u kualifikuar në këtë aksident në masën 20%, andaj shumat e gjykuara si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë vlerësuar sipas kësaj llogaritje.

Në raport me dëmin material, Gjykata e detyroi të paditurën që në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, t'ia paguajë paditësit shumën prej 180,00 Euro, duke marrë për bazë se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se kohëzgjatja e nevojshme e kësaj ndihme përkon në periudhën ditore prej 18 ditë, konform nenit 323 të LPK.

Sa i përket nevojës për ushqim të përforcuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 180,00 Euro, marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar që paditësi si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 18 ditë, konform nenit 323 të LPK.

Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto dy kategori të dëmit material (ndihma e personit të tretë dhe nevoja për ushqim të përforcuar), ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e shkaktimit të dëmit, në praktikë është dukshëm e vështirë për tu argumentuar nga ana e paditësit lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit.

Sa i përket shpenzimeve të shërimit, shpenzimet në faturat e paraqitura i përgjigjen mjekimit si pasojë e lëndimeve, por sipas llogaritjes së kuponëve fiskalë në vlerë 8 euro, 27 euro , 10 euro , 10,95 euro ,10 euro dhe 10 euro, të cilët janë të bashkangjitur në shkresa të lëndës, shuma e aprovuar duhet të jetë 75,95€ e jo shuma e kërkuar nga paditësi në lartësinë prej 130.45€. Andaj për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata është mbështetur në kuponët fiskalë të dorëzuar nga vetë paditësi.

Mbi këtë bazë, Gjykata në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke gjykuar shumat e specifikuara në këtë pikë të dispozitivit, me bindjen se në raport me dëmin material të pësuar, shumat e tilla janë të nevojshme për ta kthyer gjendjen materiale të të dëmtuarit - këtu paditësit në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi. Sa i përket dëmit jo material, Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara paraqesin një lloj satisfakcioni moral në raport me cenimin që i është bërë paditësit, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me këtë kërkesë është marrë në konsideratë rëndësia e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim se kompensimi i gjykuar nuk guxon të paraqet qëllime lukrative (fitimprurëse). Njëherit me rastin e caktimit të shumave të gjykuara Gjykata ka marr për bazë karakteristikat personale të paditësit si dhe këto shuma i ka bazuar në praktikën e gjykatave në Kosovë, lidhur me caktimin e lartësisë për dëmin jo material dhe material.

Arsyet mbi refuzimin e pjesërishtëm të padisë

Gjykata në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 3,200€, në emër të frikës shumën prej 2,300 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 90,00€, në emër të shpenzimeve të shërimit 54.5€, në emër të shpenzimeve të rehabilitimit fiziatriko për 10 ditë.

Kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej asaj që i është njohur paditësit në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin e një gjendje e cila ka qenë para shkakimit të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfakcioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirat që i janë cenuar.

Vendimi lidhur me kërkesat aksesore

Gjykata në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditësit së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.28.10.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.02.07.2019, e

deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për të dy format e dëmit (jo material dhe material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikave XIV dhe XV të këtij Mendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika IV. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 452, 453, lidhur me nenin 463.1 të LPK, duke e obliguar të paditurën që paditësit, t'ia kompensojë shumën e shpenzimeve të nevojshme dhe të domosdoshme të krijuara deri në këtë fazë të procedurës sipas kërkesës së specifikuar në vlerë të përgjithshme prej 1242,8 Euro dhe atë: shumën prej 104,00 Euro në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 60,00 Euro në emër të taksës gjyqësore për padi, shumën prej 200.00 Euro në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizave mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë edhe atë shumën prej 100.00 Euro veç e veç, si dhe për përfaqësim në 6 (gjashtë) seanca gjyqësore të mbajtura secila me nga 135,2€, për seancat e datave (22.01.2020, 08.07.2020, 04.09.2020, 04.02.2021, 03.07.2024 dhe 25.09.2024), si dhe për një seancë të shtyrë pa faj të paditësit të dt. 16.06.2020, në vlerën prej 67.6€.

Refuzohet pjesërisht si e pabazuar kërkesa e paditësit lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale sa i përket seancës së shtyrë të dt. 29.10.2019, sepse me leximin e procesverbalit të kësaj seance rezulton se kjo seancë është shtyrë me faj të paditësit. Poashtu refuzohet pjesërisht si e pabazuar kërkesa lidhur me kompensimin e shpenzimeve për përpilimin e parashtrësës për precizim të padisë të dt. 27.12.2020 sepse kjo parashtrësë nuk hyn në grupin e parashtrësave për të cilat paguhet kompensimi.

Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, gjykata ju referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrave tarifor 6 dhe 7) si dhe Udhëzimit Administrativ të KGJK lidhur me Unifikimin e Taksave Gjyqësore të dt. 22.03.2017.

Lidhur me shpenzimet e aprovuara gjykata i është referuar nenit 453 të LPK, i cili parasheh që: "453.1 Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata

do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. 453.2 Po që se është parashikuar tarifa për shpërblimin e avokatëve, apo për shpenzimet tjera, atëherë këto shpenzime do të matën sipas tarifës së tillë.”.

Bazuar në të lartcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 28.10.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.